



01Nr. 104/02-1953/24  
Kaçanik, 31.01.2024

Në mbështetje të nenit 17, shkronja (o) të Ligjit NR.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 të datës 04 Qershor 2008), të nenit 24 të Ligjit Nr. 04/L-071 për Sistemin e Adresave, si dhe të nenit 6 paragrafi 1, 2 dhe shkronja (o) të Statutit të Komunës së Kaçanikut të datës 25.09.2008 dhe ndryshimi plotësimin e Statutit të Komunës së Kaçanikut 01.nr.60/01-12895/2020 të datës 30.06.2020, Kryetari i Komunës nëpërmjet Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtjes së Mjedisit që Kuvendi Komunal Kaçanik në mbledhjen e mbajtur me 31 janar 2024, merr këtë:

### V E N D I M

#### **Për emërimin e Komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave në procesin e Emërtimit, Riemërimit të Rrugëve dhe Numërimit të Adresave për territorin e Komunës së Kaçanikut**

1. Me këtë Vendim, EMËROHET Komisioni për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave në procesin e emërtimit, Riemërimit të rrugëve dhe numërimit të adresave për territorin e Komunës së Kaçanikut, me këtë përbërje:
  - 1.1 Rrustem Zenuni anëtar (PDK)
  - 1.2 Besnik Salihu anëtar (LDK)
  - 1.3 Valon Raka anëtar (OJQ/Shoqëria Civile)
  - 1.4 Shkodran Sopa anëtar (Ekzekutivi)
  - 1.5 Kaltrina Çaka anëtare (Ekzekutivi)
2. Detyrë e Komisionit nga pika 1. e këtij vendimi është që të bëjë organizimin, grumbullimin dhe shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave të qytetarëve në procesin e emërtimit, Riemërimit të rrugëve dhe numërimit të adresave në territorin e Komunës së Kaçanikut .
3. Komisioni për punën e vetë raporton para Kuvendit të Komunës.
4. Komisioni për shqyrtimin e ankesave do të hartoj dhe miratoj kriteret e brendshme për punën e vet dhe të bashkëpunojë ngushtë edhe me ish Komisionin.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit.
6. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës të MAPL, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës.

**Me këtë Vendim njoftohen:** Kryetari i Komunës, Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit, Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit  
Kemal Murseli